

VENDIM
Nr. 37, datë 20.11.2025

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME
FIER SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (*ligji nr. 8102*), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (*rregullore e licencimit*),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 20.11.2025, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a.’”,

KONSTATON SE:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a., shkresës me nr. 1322 prot., datë 1.8.2025, me lëndë “Plotësim dokumentacioni”, shkresës me nr. 1450 prot., datë 21.8.2025, me lëndë “Plotësim dokumentacioni”, shkresës me nr. 1532/1 prot., datë 8.9.2025, me lëndë “Plotësim dokumentacioni” dhe shkresës me nr. 2137, datë 18.11.2025, me lëndë “Kërkesë me rinovim licence”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të Shoqërisë Rajonale UK Fier sh.a. në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura” (VKM-ja nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a. me (NUIS M23315402G) është themeluar më datë 8.9.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51% dhe Bashkitë Fier me 33.99 %, Patos me 5.21 %, Roskovec me 4.31 % dhe Mallakastër me 5.49 %;

b) Shoqëria Rajonale UK Fier sh.a. ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 225 721 banorë të bashkive Fier, Patos, Roskovec, Mallakastër;

c) drejtues ligjor i shoqërisë, z. Klodjan Mema, zotëron diplomë të nivelit të dytë si Jurist, viti 2010, si dhe diplomë master profesional “E drejta publike”, viti 2012 në Universitetin Justiniani 1, Fakulteti i Drejtësisë;

d) drejtues teknik i shoqërisë, z. Artur Baxhia, është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë së Minierave në vitin 1995 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Rajonale UK Fier sh.a., të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve, si aftësitë tekniko-profesionale, aftësitë financiare të nevojshme për të përmbushur

funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së Shoqërisë Rajonale UK Fier detyron:

a) Shoqërinë Rajonale UK Fier të pajiset me akt miratimet higjieno-sanitare të njësisë së ujësjellësit Bashkia Patos.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e Shoqërisë Rajonale UK Fier sh.a. është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a. me (NUIS M23315402G), në kategoritë:

a) kategoria A: për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) kategoria C: për largimin e ujërave të ndotura;

2. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) drejtues ligjor: z. Klodjan Mema;

b) drejtues teknik: z. Artur Baxhia;

3. Zona e shërbimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a. janë bashkitë Fier, Patos, Roskovec, Mallakastër.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gerta Lubonja